



TAKIM ME SHOQËRINË CIVILE DHE BIZNESIN PËR JAVËN E MBROJTJES SË VIKTIMAVE TË KRIMIT

Filluam "Javën e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit" duke u bashkuar në një aktivitet kuptimplotë: Ministria e Drejtësisë, shoqëria civile dhe biznesi. Ministri Manja shprehu që bashkimi ynë tregon se ndërgjegjësimi dhe veprimi i përbashkët janë thelbësorë në mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të krimit. Së bashku mund të parandalojmë dhe të mbrojmë viktimat e krimit. Ideja për një fond besimi për të ndihmuar viktimat e krimit për kualifikim profesional është një hap i parë i rëndësishëm drejt një shoqërie më të sigurt!

INAGURIMI I VEPRËS MURALE NË LEZHË NË MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË KRIMIT

"Javën Ndërgjegjësuere në Mbrojtje të Viktimave të Krimit" nisi nga Lezha. Së bashku me z. Murat Sahin, Përfaqësuesin e Lartë të UNICEF në Shqipëri, Bashkinë e Lezhës, dhe organizatën "Sot për të Ardhmen", u inaguruan një vepër murale e bukur për mbrojtjen e viktimave të krimit. Së bashku mund të ndërtojmë një shoqëri më të sigurt për të gjitha viktimat.



VIZITË NË QENDRËN PSIKO-SOCIALE NË VLORË NË MBYLLJE TË FUSHATËS NDËRGJEGJËSUERE NË MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË KRIMIT

Ministri Manja sëbashku me kryetarin e Bashkisë z. Ermal Dredha, vizituan qendrën psiko-sociale "Vatra" në Vlorë, duke shënuar përfundimin e fushatës së parë ndërgjegjësuere për mbrojtjen e viktimave të krimit. Me bashkëpunimin e institucioneve lokale, shoqërisë civile dhe bizneseve, po ndërtojmë një shoqëri më mbështetëse për viktimat e krimit. Manja shprehu faleminderime për mbështetjen e tyre në këtë nismë të rëndësishme!



ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË KOMITETIT EVROPIAN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS (CPT)

Ministria e Drejtësisë sëbashku me Avokaten e Popullit, znj. Erinda Ballanca, organizuan një sesion pune të përbashkët me aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë, për të diskutuar gjetjet e raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) mbi trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Shqipëri. Ky dialog konstruktiv synoi të bashkojë përpjekjet për të adresuar

